- 19. Hapja e Ofertave** Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

D. SHQYRTIMI I OFERTAVE

- 20. Konfidencialiteti** Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

- 21. Sqarimi i ofertave** 1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

- 22. Përgjegjshmëria e ofertave** 1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

- 23. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik** 1. Për një pjesë të kriterëve të pranimi të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. Operatori ekonomik mund të përdorë një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

24. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

25. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1= Vmink1 \times Pmaxk1/Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik

Nënkriteret⁴

i/a Përvoja për punë të ngjashme

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

(ii) Metodologjia e Propozuar

Nënkriteret

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës.

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit.

⁴ Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.

Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- a- Kualifikim i përgjithshëm;
- b. Eksperienca në fushën përkatëse;
 - Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
 - Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën e prokurimit të pavlefshme.

2. Autoriteti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.
3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:
 - (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
 - (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sherbim organizimi aktivitetesh kulturore, sportive dhe sociale per vitin 2026		
Nr.	Emertimi	Terma Reference/ Specifikime Teknike
1. Hapja e sezonit turistik (Dr Turizmit)		
1	Sherbim me qera skene portative	Marrja me qera skena portative me 140 cm lartësi, Skena duhet të jetë e qëndrueshme me sipërfaqe 60 m2 që të rris standartin e aktivitetesh të Bashkisë Lezhë, Strukturë e qëndrueshme për përdorim të jashtëm, Material: çelik dhe alumini i trajtuar, DysHEME e fortë dhe rezistente ndaj peshës së ekipit dhe artistëve, Sigurim i stabilitetit me mbështetje shtesë për terrene të ndryshmePërshtatje për performanca live, koncerte dhe aktivitete promovuese . Pësha e ngarkimit 750 Kg/m2 - sipas DIN 15921 Sipërfaqja e sipërme: dru i laminuar kafe me teksture ekzagonale.

2	Sherbim me qera pajisje audiofonike, sistem mikrofona wireles për koncert live	Pajisje audiofonike, sistem mikrofona wireles për koncert live & dj (25.000 watt – rms)- (me 3 sisteme) (bas-mid-stereo-monitora) dhe urat mbajtëse për sistemin e pajisjeve audio-fonike dhe podin për pult komand, Pajisjet përfshijnë: amplifikatorë, monitorë skene dhe urat mbajtëse, Pod për pult komand të kontrollit audio, Instalimi për performancë të jashtme dhe të brendshme, Sigurim i cilësisë së zërit, pa ndërprerje dhe me mbulim të plotë të skenës, 6 mikrofona valor.
3	Sherbim me Qera për ndricimin e skenës	Ndriçimi artistik i skenës me sisteme light , 8 rrobote & komand automatik me mikser etj) Ndriçim LED dhe spot për efekt artistik, Kontroll automatik për ndryshim, ngjyrash dhe efektesh, Mikser i integruar për sinkronizim me muzikën dhe performancën, Instalim i përshtatshëm për skenë portative dhe outdoor.
4	Fishekzjarre	Blerje Fishekzjarre: Ne forme kutie me 100 shperthime, multi-shot cake, lartesia fluturimit 30-80m, kohezgjatja 90 sekonda, distanca e sigurte 30-5-m Blerje Fishekzjarre: Ne forme kutie me 100 shperthime, multi-shot cake, lartesia fluturimit 30-80m, kohezgjatja 90 sekonda, distanca e sigurte 30-5-m Blerje fishekzjarre qe leshojne shkendija nga toka, lartesia e shkendijave shkon deri ne 3 metra, kohezgjatja 60 sekonda, efekti shkendijave ngjyre ari ose argjenti. Blerje fishekzjarre qe leshojne shkendija nga toka, lartesia e shkendijave shkon deri ne 3 metra, kohezgjatja 60 sekonda, efekti shkendijave ngjyre ari ose argjenti.
5	Sherbim me qera LED Wall	Marrja me qera LED Wall me permasa 6m x 4 m, Material: LED modul modern, rezistent ndaj kushteve atmosferike, Rezolucion: i lartë për shfaqje video dhe informacione vizuale, Montim mbi skenë ose strukturë të pavarur, Kontroll i integruar për shfaqje të ndryshme (video, grafika, tekste).
2. Festa e Sheges (Dr. Turizmit)		
1	Dekor	Blerja e shportave, Materiali: druri ose materiale natyrale, rezistente, Funksion: përdorim për dekor në aktivitet/promovim, Dizajn: i përshtatshëm për vendosje të produkteve natyrale (shega), me diameter 40cm , ngjyre kaf. Blerja e shegave, Origjina: e freskët, e pjekur, e gatshme për përdorim gastronomik ose dekorativ, Cilësia: fruta të plotë, pa dëmtime ose myk, Funksion: gatim dhe ekspozim në aktivitetin promovues. tabele me forex ne forme shege me permasa 1x2m2 , Materiali: forex 5 mm, Printimi: full color, Funksion: dekor vizual për event/promovim.

2	Sherbim me set aksesori kuzhine	Set aksesori kuzhine me perberje (lugë, tasa,pjata,pirunj,gota), Materiali: karton ose plastik , Funksion: përdorim për gatim dhe shërbim gjatë aktivitetit, Cilësia: e qëndrueshme dhe e lehtë për përdorim.(cdo set ka 1lug, 1 pirun, 1 tas , 1 pjate, 1 gote)
3	Sherbim me soba me qira	Soba me qira me 4 vatra gazi për qellim gatimin e produkteve me shëgjë, Siguria: me mbrojtje ndaj flakës së hapur, e përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme, Transport dhe instalim i përfshirë.
4	Baner	Baner permasat 3 x 4 m duhet të jetë me skelet druri sipas përmasave të kërkuara, Materiali: banner printim full color, Skeleti: druri i trajtuar, i qëndrueshëm për montim dhe terrene të jashtme Funksion: ekspozim i aktivitetit/promovimit. Baner (permasat 2 x 3)m duhet të jetë me skelet druri sipas përmasave të kërkuara, Materiali: banner printim full color, Skeleti: druri i trajtuar, i qëndrueshëm për terrene të jashtme, Funksion: ekspozim i aktivitetit/promovimit.
3. Broshura dhe fletëpalosje (Dr. Turizmit)		
1	Blerje broshura	Formati : 12x20.5cm 44fletë(88faqe) letra 130gr mat + plastifikim mat me ngjitje dhe kopertinen.
2	(Çantë)	Përmasa: 30 × 25 cm (gjerësi × lartësi) Thellësia: 10 cm Material: Karton i fortë 250–300 gr (kraft ose i bardhë mat) Lloji: Çantë dhuratë me palosje anësore Tematikë: Pamje karakteristike nga Lezha Kalaja e Lezhës Detaje urbane ,historike Dorezat Material: Spango pambuku ose letër e përdredhur Ngjyra: E bardhë, bezhë , jeshile e errët Fiksimi: Me nyje të brendshme të përforuara. Ose cdo ekuivalent
3	(stilolaps,)	Material: Plastikë cilësore ose metal i lehtë Ngjyra: E bardhë ,blu e errët ,jeshile Printimi:Logo ose emërtim i Lezhës Printim 1-ngjyrësh Mekanizmi: Klikues Ngjyra e bojës: Blu
4	(kartolina)	Përmasa: A6 (10.5 × 14.8 cm) Material: Karton 300 gr mat Dizajni:Pamje nga Lezha (e njëjta linjë grafike me çantën) Pjesa e pasme:Hapësirë për mesazh Logo ose tekst institucional Printimi: Full color, dy anë.
4. Dita e Shtegtarëve (Dr. Turizmit)		

1	Sherbim per marrje me qera skena portative	Marrja me qera skena portative me 140 cm lartësi, Skena duhet të jetë e qëndrueshme me sipërfaqe 60 m² që të rris standartin e aktiviteteve të Bashkisë Lezhë, Strukturë e qëndrueshme për përdorim të jashtëm, Material: çelik dhe alumini i trajtuar, Dyscheme e fortë dhe rezistente ndaj peshës së ekipit dhe artistëve, Sigurim i stabilitetit me mbështetje shtesë për terrene të ndryshme Përshtatje për performanca live, koncerte dhe aktivitete promovuese Pesha e ngarkimit 750 Kg/m² - sipas DIN 15921 Sipërfaqja e sipërme: dru i laminuar kafe me teksture ekzagonale, Skena do te rrije e montuar per 4 nete.
2	Sherbim për marrje me qera ndricimin e skenës	Ndriçimi artistik i skenës me sisteme light – 10 rrobote & komand automatik me mikser etj), Shërbimi për ndricimin artistik të skenës me rrobotet e specifikuar si dhe me coloret dhe ngjyrat e ndryshme. Ndriçim LED dhe spot për efekt artistik, Kontroll automatik për ndryshim, ngjyrash dhe efektesh, Mikser i integruar për sinkronizim me muzikën dhe performancën, Instalim i përshtatshëm për skenë portative dhe outdoor. ndricimi duhet te jete i instaluar per 4 nete
3	Sherbim me pajisje audiofonike	Pajisje audiofonike, system mikrofona wireles për koncert live & dj (30000watt –rms)- (me 3 sisteme)(bas-mid-stereo monitora) dhe urat mbajtëse për sistemin e pajisjeve audio-fonike dhe podin për pult komande të kontrollit audio, Instalimi për performancë të jashtme, Sigurim i cilësisë së zërit, pa ndërprerje dhe me mbulim të plotë të skenës, 10 mikrofona valor. audio duhet te jete e instaluar per 4 nete
4	Sherbim për marrje me qera led wall	Marrja me qera LED Wall me permasa 7x5 m, Material: LED modul modern, rezistent ndaj kushteve atmosferike, Rezolucion: i lartë për shfaqje video dhe informacione vizuale, Montim mbi skenë ose strukturë të pavarur, Kontroll i integruar për shfaqje të ndryshme (video, grafika, tekste). Njesia e jashtme e ekranit LED fikse P3.9 per abjente te jashtme Konfigurimi i pikselit: 1R1G1B Kategoria Pixel Pitch: P3.91 Hapi i pikselit: 3.91 mm Modulet perberëse: trup alumini croluci ni: 12 dhe 13 piha 1m: 0.5 Dendësia e pikselit: 65536 pika/m' Strehimi i tabelës se llambes: Po Materiali i kabinetit: Profil alumini Shtresësia e kabinetit: 0.8 mm Niveli i mbrojtjes: 1P67 (F) / 1P66 (R) Shkëlqimi i bilancit te bardhe: 5000 Temperatura e ngjyrës: 3000K-10000K

		Këndi i shikimit: 160°(H)/80°(V) Uniformiteti i ndriçimit: $\geq 95\%$ Uniformiteti i ngjyres: $\geq 95\%$ Raporti i kontrastit: 5000:1 Shpejtësia e kornizes: 50/60 HZ Shkalla e rifreskimit: 3840 Niveli gri: 14 bit ngjyra e ekranit: DCI-P3. led walli duhet te jete i instaluar per 4 nete.
5. Konference promovuese Lezha (Dr. Turizmit)		
1	Botimi i materialit	Formati: A5 Numri i faqeve: 20 faqe Kopertina: Karton 200 gr Brendësia: Letër 130 gr Printimi: Full color, dy anë Gjuha: Shqip, anglisht Përmbajtja: Pamje turistike nga Lezha ,informacion historik dhe kulturor.
6. Promovimi i shtigjeve malore (Dr. Turizmit)		
1	Sinjalistikë ekologjike(tabela druri informuese)	Tabela druri informuese Materiali: dru cilësor, i papërshkueshëm nga lagështia , me dy ndarje drejtimesh. Printimi: Informacion ekologjik dhe udhëzues për turistët. Dimensionet: 60cm x 20 cm Dizajni: vizual dhe tekst informues Rezistencë ndaj kushteve atmosferike Montim: me mbështetëse .
2	Mbështetëse për terrene të vështira (Mbajtëse druri)	Mbajtëse druri për terrene të vështira Material: dru cilësor Lartësia: 1.5 deri 2 m Dizajn i qëndrueshëm për terrene të vështira
3	Mbështetëse për terrene të vështira (Litarë)	Material: PVC i fortë, rezistent ndaj lagështisë dhe motit malor Funksion: mbështetje dhe sinjalizim i shtigjeve malore, i lehtë për transport dhe montim, i qëndrueshëm për terrene të vështira.
4	Adeziv me forex për tabela informuese.	Material: adeziv i fortë, rezistent ndaj lagështisë dhe temperatures, Dimensionet: 60cm x 20 cm
7. Muzeu në Kalanë Lezhë (Dr. Kultures)		
1	Blerje kabull	Kabull elektrik për të lidhur energjinë elektrike tre fazor 4x25ml 2 alumini per nentoke XLPE
8. Materjale për Muzeun (Dr. Kultures)		
1	Flamuj kuq e zi	Përmasat e Flamurit : 1,5 gjerësi me 1 metër lartësi. Përmasat e Shqiponjës në Flamur: 65 cm lartësi x 60 cm gjerësi. - Flamujt duhet të jenë me material atlas ose çdo material tjetër

		textile, i qëndrueshëm dhe i printuar në ,mënyrë digitale, jo i qëndisur dhe jo i pikturuar
2	Solucion kimik për trajtimin e bronzit - metaleve të ndryshme	Ujë i distiluar për hollimin e kimikateve profesionale.
		Detergjent neutral Benzotriazole (BTA), solucion i lëngshëm (benzinë më cilësore për pastrimin e ndryshkut).
		Dyell mikrokristalor për ta përdorur kundër ndryshkut. Për shkelqim natyral dhe të ngrohtë dhe ruan pamjen origjinale të materialve)
3	Pesticide për eliminimin e vegjetacionit të lartë - të ulët	Pesticide është solucion i lëngshëm (koncentrat) i cili shërben për eliminimin e barërave të padëshiruara dhe bimeve të egra
4	Boks per Memorialin (per ciceronin e memorialit)	Boks per Memorialin 30W, me bateri 1800mAh me zgjatje 1.5 ore , i cili ka Brenda 1 mikrofoni pa tel, 1 kablllo ngarkimi, 1 telekomandë për kontroll.
9. Çmimi At Zef Pllumbi (Dr. Kultures)		
1	Pllakata per fituesit e konkursit	Blerje Pllakata duhet të jetë me material metalik me përmasat e formatit A4 me dimension 210 mm gjerësi dhe 297 mm lartësi. Duhet të jetë e gdhendur me lazer në gjithë punimin që përmban që nga logo e bashkisë dhe shkrimi dhe foto që përmban. Duhet të jetë e vendosur në kuti të veshur me material prej Gamoshi me ngjyrë të kuqe.
10. Dita 5 Maji Dita e Dëshmorëve (Dr. Kultures)		
1	Kurora per ceremonine zyrtare:	Blerje Kurora me lule përbëhet vetëm nga lule natyrale të çdo lloji dhe të stinës, jo domosdoshmërisht aromatike. Duhet të përmbaje një shirit që përshkon gjithë diametrin në pozicionin skich me gjerësi 15 – 20 cm me mbishkrimet sipas aktivitetit ose ceremonisë. Diametri i kurorave 60 – 70 cm dhe duhet te kenë gjithmonë të njëjtin standart në formë, dhe të ndryshuar vetëm ngjyrën e luleve sipas stinës.
11. Maj 2026 Ngjyrat e Lezhës, Festivali i Artit në Natyrë (Dr. kultures)		
1	telajo	Telajo me pambuk me strukture druri me permasa 40cm x 40 cm
2	Letër e trashë kolor (A3, A4);	Blerje Letër e trashë kolor (A3, A4);
3	Penela të ndryshëm ; 100 sete	Blerje Penela me material sintetik,me doreze plastik me densitet te ndryshem te fijeve
4	Ngjyra uji (akuarel), 100 kuti	Blerje Ngjyra uji (akuarel), tablet me 8 ngjyra, pigmente cilesore te tretshme ne uje.

5	Ngjyra tempera (kolektive); 40 kuti	Blerje Ngjyra tempera (kolektive), 6 ngjyra me 25ml , me kuti plastike
6	Rrula & lapsa vizatimi ; 200 sete	Blerje Rrula te vegjel 15cm x 2.5mm & lapsa vizatimi me ngjyra te ndryshme
7	Pëlhurë e bardhë për pikturë; 100 m	Blerje Pëlhurë e bardhë për pikturë 30x30cm
8	Qese plastike për pastrim; 10 (paketa)	Blerje Qese plastike për pastrim 80x120cm
12. Festa 1 Qershor Aktivitet Artistik (Dr. Kultures)		
1	Tullumbace	Tullumbace dekorative te zakonshme
2	Flamuj dekorativë shumëngjyrësh	shirit me flamuj trekendesh dekorativë shumëngjyrësh 10meter
3	Stenda/fotokënd 3D	forex 100x150cm me kembe mbajtese me shkrim gezuar 1 qershorin
4	Ngjitëse rrugore Figura lozonjare për tokën 10 m²	Ngjitëse rrugore Figura me animacione per tu ngjitur ne toke
5	Postera mirëseardhjeje dhe urime 100 copë	Postera mirëseardhjeje dhe urimi ne forme dhe permase kartoline.
13. Panairi veror i Librit (Dr. Kultures)		
1	Pllakata per 3 fituesit	Blerje Pllakata duhet të jetë me material metalik me përmasat e formatit A4 me dimension 210 mm gjerësi dhe 297 mm lartësi, në bazë të formatit të kërkuar nga aktiviteti. Duhet të jetë e gdhendur me lazer në gjithë punimin që përmban që nga logo e bashkisë dhe shkrimi dhe foto që përmban. Duhet të jetë e vendosur në kuti të veshur me material prej Gamoshi me ngjyrë të kuqe.
2	Marrje me qira Karrige per aktivitetin	Stili i karriges: klasik, elegant që ti përshtatet tematikës së ceremonisë ngjyrë të zezë ose bardhë. Struktura metal i qëndrueshëm ose dru i fortë. Lartësia totale 85-100 cm. gjerësia e 45 – 55 cm.
3	Blerja e librave	Blerja e librave në panair , romane
		Blerja e librave në panair , poezi dhe histori
14. Aktiviteti 5 Shtator - Nene Tereza (Dr. kultures)		
1	Printim (me forex) për ekspozim publik	Printim (me forex) posterit me citate të Nënë Terezës kudo ne qytet me A3
		Printim (me forex) posterit me citate të Nënë Terezës kudo ne qytet me A2

2	Letër / materiale vizatimi për fëmijë, Vizatime, citate, pankarta.	Letra vizatimi A4 (me ngjyra dhe e bardhë) për Vizatime dhe pankarta të vogla
		Ngjyra vizatimi/temperë për gjyrosje, vizatime dhe citate.
		Furçë dhe lapsa ngjyra per detaje në vizatime dhe citate.
		Shirit ngjitës (ngjitës universal) për ngjitje vizatimesh, pankartash në mure.
3	Bojra dhe materiale për instalacione artistike në vendet e parashikuara	Bojra akrilike për ngjyrosje instalacionesh 3D
		Karton i trashë (i valëzuar) i cili shërben si bazë për figura dhe simbole 3D)
		Shkumë që shërben për figura, lule, objekte të lehta për instalacione
		Letra ngjyra dhe stikerë që shërben për dekorim sipërfaqesh.
		Letra ngjyra dhe stikerë për dekorimin .
15. Festivali i Balonave Lezhë MAJ 2026 (Dr. Kultures)		
1	Material për ndërtim balonash për 100 pjesëmarrës : Letër, bambu, pëlhurë, ngjitës.	Letër me ngjyra (karton) per dekorime dhe vizatime për balona A2
		Bambu (shkopinj të vegjël) për balonat
		Pëlhurë e lehtë (e gatshme) që shërben si pjesë dekorative për balona
		Ngjitës shirit dyanësh
2	Dekor i vendit	Balona të varura me mbishkrime
3	Fotokënd dhe instalacione për foto: 1 kënd i madh dekorativ	printim1 kënd i madh dekorativ me permasa 200x250cm
16. Aktiviteti At Gjergj Fishta 23 Tetor (Dr. kultures)		
1	Pllakata për fituesit e konkursit.	Pllakata duhet të jetë me material metalik me përmasat e formatit A4 me dimension 210 mm gjerësi dhe 297 mm lartësi, në bazë të formatit të kërkuar nga aktiviteti. Duhet të jetë e gdhendur me lazer në gjithë punimin që përmban që nga logo e bashkisë dhe shkrimi dhe foto që përmban. Duhet të jetë e vendosur në kuti të veshur me material prej Gamoshi me ngjyrë të kuqe, vishnje ose blu dhe me logon e bashkisë dhe shkrimi të jetë i printuar me lazer me ngjyrë të artë.
2	Baner për aktivitetin 7 x 6m	Blerje Baner me Portretin e Fishtës me përmasa 7m x 6m, dhe me mbajtëse për banerin (material hekuri)
3	Printim me forex	Printim me forex per aktivitetin A3
		Printim me forex per aktivitetin A2
17. Çlirimi i Lezhës 20 Nëntor (Dr. Kultures)		

1	Kurora per ceremonine zyrtare:	Blerje Kurora me lule përbëhet vetëm nga lule natyrale të çdo lloji dhe të stinës, jo domosdoshmërisht aromatike. Duhet të përmbaje një shirit që përshkon gjithë diametrin në pozicionin skich me gjërësi 15 – 20 cm me mbishkrimet sipas aktivitetit ose ceremonisë. Diametri i kurorave 60 – 70 cm dhe duhet të kenë gjithmonë të njëjtin standart në formë, dhe të ndryshuar vetëm ngjyrën e luleve sipas stinës.
2	Banderola	Blerje Banderola me material pelhure me permasa 1m x 3m,
18. Festa e Çlirimit 28-29 Nëntori (Dr. Kultures)		
1	Kurora per ceremonine zyrtare	Blerje Kurora me lule përbëhet vetëm nga lule natyrale të çdo lloji dhe të stinës, jo domosdoshmërisht aromatike. Duhet të përmbaje një shirit që përshkon gjithë diametrin në pozicionin skich me gjërësi 15 – 20 cm me mbishkrimet sipas aktivitetit ose ceremonisë. Diametri i kurorave 60 – 70 cm dhe duhet të kenë gjithmonë të njëjtin standart në formë, dhe të ndryshuar vetëm ngjyrën e luleve sipas stinës.
2	Flamuj kuq e zi për dekor	Flamuj kuq e zi për dekor: 1m x 4 m material atlas I plote
3	Tabela me adeziv	Printime per Tabela me permasa 60x70 cm
19. Aktivitete promovimi dhe informimi (Dr. Kultures)		
1	Fletepalosje A4	Printim Fletepalosje A4 per promovim
2	Baner me permasa 6m x 7m	Baner me permasa 2x3 m , me strukture druri te qendrueshme.
3	Roll up me permasa 2 x 1,5	Blerje Roll up me permasa 2 x 1,5 m
4	Forex per aktivitete ndryshme	Printim Forex per aktivitete te ndryshme me format A3
		Printim Forex per aktivitete te ndryshme me format A2
20. Festat e Fundvitit (Dr. Kultures)		
1	Blerje fishekzjarre	Blerje Fishekzjarre: Ne forme kutie me 100 shperthime, multi-shot cake, lartesia fluturimit 30-80m, kohezgjatja 90 sekonda, distanca e sigurte 30-5-m
		Blerje Fishekzjarre: Ne forme kutie me 100 shperthime, multi-shot cake, lartesia fluturimit 30-80m, kohezgjatja 90 sekonda, distanca e sigurte 30-5-m
		Blerje fishekzjarrje qe leshojne shkendija nga toka, lartesia e shkendijave shkon deri ne 3 metra, kohezgjatja 60 sekonda, efekti shkendijave ngjyre ari ose argjenti.
		Blerje fishekzjarrje qe leshojne shkendija nga toka, lartesia e shkendijave shkon deri ne 3 metra, kohezgjatja 60 sekonda, efekti shkendijave ngjyre ari ose argjenti.
21. Kampionati Ping-Pong (Dr. Arsimit)		
1	Kupa Vendi i Parë	Kupa Vendi i Parë me gjatësi 40 cm me pllakade te shkruar poshtë kampionati ping pingut vendi i pare Bashkia Lezhe per djem dhe vajza

2	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi I pare.
3	Medalje vendi i dytë	Medalje vendi i dytë ngjyre argjendi me shkrim vendi I dyte
4	Medalje vendi i tretë	Medalje vendi i tretë ngjyre bronxi me shkrim vendi trete.
5	Set me raketa dhe topa ping-pongu	Set me 2 raketa dhe 3 topa ping-pongu
6	Numërues (tabla për pikët)	Numërues (tabla për pikët)
22. Fëmijë me Aftësi Ndryshe (Dr. Arsimit)		
1	Telajo	Telajo me pambuk me strukture druri me permasa 40cm x 40 cm
2	Bojëra akrelike	Bojëra akrelike (set me 8 ngjyra te ndryshme)
3	Pistoleta me Flluska uji	Pistoleta me flluska uji për fëmijë me permasa 15x16.7x7.6 cm
23. Dita e Shkopit të Bardhë (Dr. Arsimit)		
1	Shkop për të verbër	Shkop për të verbër
2	Domino për të verbër	Domino të përshtatur për të verbër
3	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi I pare.
24. Kampionati i Shahut (Dr. Arsimit)		
1	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi pare.
2	Medalje vendi i dytë	Medalje vendi i dyte ngjyre argjendi me shkrim vendi dyte.
3	Medalje vendi i tretë	Medalje vendi i trete ngjyre bronxi me shkrim vendi trete.
4	Kupa vendi i parë	Kupa Vendi i Parë me gjatësi 40 cm me pllakade te shkruar poshtë kampionati shahut vendi i pare Bashkia Lezhe per djem dhe vajza
5	Tabela shahu profesionale druri	Tabela shahu profesionale druri me permasa 48x48cm
25. Aktiviteti Beach Volay (Dr. Arsimit)		
1	Rrjetë profesionale	Rrjetë profesionale 7.5mx91.5cm materiali poliamid(nylon)kablllo tensionues celiku.
2	Kupa vendi i parë	Kupa Vendi i Parë me gjatësi 40 cm me pllakade te shkruar poshtë kampionati shahut vendi i pare Bashkia Lezhe per djem dhe vajza
3	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi pare.
4	Medalje vendi i dytë	Medalje vendi i dyte ngjyre argjendi me shkrim vendi dyte.

5	Medalje vendi i tretë	Medalje vendi i trete ngjyre bronxi me shkrim vendi trete.
6	Topa profesional volejbolli cilësor	Topa profesional volejbolli cilësor V330W, masa 5, 260-280g. Competition performance
7	Uniforma sportive	Uniforma sportive (jeleke)2 cope ngjyre te kuqe, 2 cope ngjyre jeshile, 2 cope ngjyre roze, 2 cope ngjyre te bardhe, 2 cope ngjyre bojqielli, 2 cope ngjyre portokalli, 2 cope ngjyre te verdhe, 2 cope ngjyre te zeze, 2 cope ngjyre bezhe, 2cope ngjyre blu
26. Garat me kajakë (Dr. Arsimit)		
1	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi pare.
2	Medalje vendi i dytë	Medalje vendi i dyte ngjyre argjendi me shkrim vendi dyte.
3	Medalje vendi i tretë	Medalje vendi i trete ngjyre bronxi me shkrim vendi trete.
4	Kupa vendi i parë	Kupa Vendi i Parë me gjatësi 40 cm me pllakade te shkruar poshtë kampionati shahut vendi i pare Bashkia Lezhe
5	Jelek shpëtimi per varka	Jelek shpëtimi per varka materiali poliester plastik ngjyre portokalli, masa L
6	Lopata alumini për kajakë	Lopata alumini ngjyre gri me gjatesi 145 cm për kajakë
27. Kampionati i Volejbollit (Dr. Arsimit)		
1	Kupa vendi i parë	Kupa Vendi i Parë me gjatësi 40 cm me pllakade te shkruar poshtë kampionati shahut vendi i pare Bashkia Lezhe
2	Topa profesional volejbolli cilësor	Topa profesional volejbolli cilësor V330W, masa 5, 260-280g. Competition performance
3	Bluza volejbolli	Bluza volejbolli , material sintetik me elasticitet me vija kuq e verdhe 6 cope masa L dhe 4 cope masa XL
4	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi pare.
5	Medalje vendi i dytë	Medalje vendi i dyte ngjyre argjendi me shkrim vendi dyte.
6	Medalje vendi i tretë	Medalje vendi i trete ngjyre bronxi me shkrim vendi trete.
28. Kampionati i Futbollit Emig. (Dr. Arsimit)		
1	Medalje vendi i parë	Medalje vendi i parë ngjyre ari me shkrim vendi pare.
